



Planuar / Doretuar Prenjshëm/Prodato Received/Delivery	25. 11 2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHQ/	7426/2022		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.905/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Çlirim Zeka -Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.905/2022 të datës 13.10.2022 të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizimin e përfaqëson Avokat me adresë: në Prishtinë, kundër Vendimit me numër:016-11549 të Menaxherit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjilanit i datës 30.09.2022, në çështjen juridike "Ndërprerje e marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 25.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e bazuar ankesa A.nr.905/2022 e datës 13.10.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. MBETET në fuqi Vendimi me numër:016-11549 i nxjerr nga Menaxheri i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjilanit i datës 30.09.2022.

A r s y e t i m

Ankuesi, i cili sipas shkresave të lëndës është i punësuar në Komunën e Gjilanit, kundër Vendimit me numër:016-11549 të Menaxherit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjilanit i datës 30.09.2022, përmes postës me datë 11.10.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil e cila është pranuar në Këshill me datë 13.10.2022 dhe është regjistruar me numër protokoli:6145/2022.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill, pretendon se vendimi i goditur përmes kësaj ankese është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën Administrative sikurse edhe me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, me arsyetimin se sipas Vendimit të datës 06.07.2022 të nxjerrë nga Kryetari i Komunës së Gjilanit ankuesi ishte kthyer në venin e punës, ndërsa sipas të njëjtit nga momenti i kthimit në vendin e punës nga data 06.07.2022 deri në momentin e pranimit të vendimit për përfundimin e marrëdhënies së punës të datës 30.09.2022, nuk ka kryer asnjë shkëlje, ndërsa sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan dënimi me burgim efektiv prej tre (3) muajsh i është shndërruar në dënim me gjobë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Komunën e Kamenicës. Këshilli, me datë 03.11.2022 me numër protokoli:6686/2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 13.10.2022, të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 03.10.2022; Vendimin për Përfundimin e Marrëdhënies së punës me numër:016-11549 i nxjerr Menaxherit i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjilanit i datës 30.09.2022; Aktgjykimin PKR.nr.102/22 të Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Krimeve të Rënda i datës 10.08.2022; Vendimin e Kryetarit të Komunës së Gjilanit me numër:696 i datës 06.07.2022; Listën e pagave për muajin korrik-gusht 2022; Zarin postar me shifër:RN2593561; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigjen e datës 03.11.2022 të pranuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjilanit; Akt Emërimit e ankuesit i datës 03.03.2011; Kërkesën e datës 10.05.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore; Njoftimin e datës 12.05.2022 të Gjykatës Themelore të Gjilanit; Vendimin e datës 13.05.2022 të Kryetarit të Komunës së Gjilanit; Kërkesën e datës 03.06.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore; Njoftimin e datës 07.06.2022 të Gjykatës Themelore të Gjilanit; Vendimin e Kryetarit të Komunës i datës 29.06.2022; Formularin për kërkesë apo ankesë i datës 18.07.2022; Vendimin e Këshillit A.nr.532/2022; Vendimin e Kryetarit të Komunës i datës 06.07.2022; Formularin për kërkesë apo ankesë i datës 26.09.2022; Zarin postar me shifër:RN2646911.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e pabazuar, sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në shkresat e lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankuesi në bazë të Aktit të Emërimit më numër:02-16-2698 të datës 03.03.2011 i llojit të emërimit: I karrierës/pa afat është i punësuar në Komunën e Gjilanit, në pozitën: "Zyrtar i Gjendjes Civile-Verbic e Zhegocit", ndërsa të njëjtin fillimisht Kryetari i Komunës së Gjilanit përmes Vendimit të datës 13.05.2022 e kishte pezulluar nga puna nga data 06.05.2022, pas informatës së pranuar zyrtare me datë 12.05.2022 nga Gjykata Themelore e Gjilanit pasi që ankuesit sipas kërkesë zyrtare të Prokurorisë Themelore në Gjilan i është caktuar masa e paraburgimit nga data 06.05.2022

deri me datë 04.06.2022 me dyshimin se i njëjti ka kryer veprën penale "keqpërdorimi i pozitës zyrtare apo autoritetit zyrtar".

Po ashtu, Kryetari i Komunës së Gjilanit përmes Vendimit të datës 29.06.2022 ankuesit ia kishte vazhduar masën e pezullimit nga data 05.06.2022 deri me datë 01.08.2022, ndërsa pas informatës së pranuar zyrtare me datë 07.06.2022 nga Gjykata Themelore e Gjilanit se ankuesit pas ngritjes së aktakuzës nga Prokuroria Themelore në Gjilan i është ndërprerë masa e paraburgimit, ndërsa i njëjti gjendet në arrest shtëpiak deri me datë 01.08.2022. Ndërsa Kryetari i Komunës së Gjilanit, me datë 06.07.2022 përmes Vendimit me numër: 696 i shfuqizon Vendimin e datës 29.06.2022 dhe Vendimin e datës 13.05.2022 ku ankuesi ishte pezulluar nga puna, duke ia mundur ankuesit që të kthehet në vendin e tij të punës nga data 07.07.2022 deri në përfundimin e procedurës penale nga instancat gjyqësore.

Kolegji i Këshillit, gjithashtu ka konstatuar se sipas Aktgjykimit PKR.nr.102/22 të Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Krimeve të Rënda i datës 10.08.2022, ankuesi është shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale keqpërdorim i detyrës zyrtare apo autoritetit nga nenin 414 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, me arsyetimin se, **citoj:** "Nga viti 2016 e deri në vitin 2022, i pandehuri i njëjti në cilësinë e personit zyrtar në Shërbimin e Gjendjes Civil në fshatin Bresalcë dhe fshatin Verbicë e Zhegovcit, duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin e tij zyrtar, me qëllim të përfitimit të qafredo dobie për vete apo personin tjetër, apo që t'i shkaktojë dëm personit tjetër, me dashje, ka tejkaluar kompetencat dhe ka shkelur detyrat e tij të domosdoshme të përcaktuara me ligj, duke vepruar në kundërshtim me nenin 32 të udhëzimit Administrativ 18/2013, në atë mënyrë që personat e poshtëshënuar, i ka regjistruar si banorë të shtetit të Kosovës dhe atë:

ka marrë pension deri me datë 20 mars 2017 (lajmërimi i fundit 06 qershor 2016),

merr pension nga viti 2019-vazhdon (lajmërimi i fundit shkurt 2022),

merr

pension nga viti 2019-vazhdon (lajmërimi i fundit 01 nëntor 2022),

prej vitit 2019-

vazhdon (lajmërimi i fundit 01 nëntor 2021, prej vitit 2019-vazhdon, me këto veprime i pandehuri e ka dëmtuar Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve-Buxhetin e republikës së Kosovës në shumë të papërcaktuara". Po ashtu, Kolegji i Këshillit thekson faktin se sipas përmbajtës së Aktgjykimit PKR.nr.102/22 të Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Krimeve të Rënda i datës 10.08.2022, konstatohet fakti se ankuesi e ka pranuar fajësinë për veprën e kryer penale, ndërsa dënimi i shqiptuar me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqindetëdhjetë) ditëve, me pëlqimin e tij i shndërrohet në dënim me gjobë, sikurse konstatohet fakti se aktgjykimi i lartcekur e ka marr formën e plotfuqishmërisë së tij me datë 05.09.2022.

Ndërlidhur si më lartë, Menaxheri i Njesisë së Burimeve Njerëzore me datë 30.09.2022 përmes Vendimit me numër:016-115495 ia konfirmon ankuesit përfundimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil nga data 01.10.2022, me arsyetimin se i njëjti sipas Aktgjykimit PKR.nr.102/22 të Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Krimeve të Rënda të datës 10.08.2022 është shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale keqpërdorim i detyrës zyrtare apo autoritetit nga nenin 414 paragrafi 1 të KPRK-së me dënimin e shqiptuar për mbajtjen e burgimit prej 180 ditësh.

Me qëllim të shqyrtimit të ligshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik përkatësisht paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 dhe 1.6 si dhe paragrafin 4 nën paragrafi 4.1 të nenit 60 ku përcaktohet se: "Marrëdhënia e

punës në Shërbimin Civil përfundon për shkak të ligjit, kur: 1.5. dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje; 1.6. dënohet me vendim të formës së prerë për çfarëdo vepre penale, për mbajtjen e burgut efektiv për tre (3) muaj e më tepër. 4. Përfundimi i marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil, për shkak të ligjit, konstatohet jo më vonë se brenda 5 ditëve nga ndodhja apo njohja e shkakut të përfundimit, nga: 4.1. Njësia e Burimeve Njerëzore e institucionit, ku nëpunësi ushtron detyrën” dhe ka konstatuar se Menaxheri i Njesisë së Burimeve Njerëzore i Komunës së Gjilanit me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër:016-115495 me datë 30.09.2022 përmes të cilit ankuesit ia ka konfirmuar përfundimin e marrëdhënies së punës sipas fuqisë së ligjit, ka vepruar në pajtueshmëri me kompetencat dhe përgjegjësit që ia kanë garantuar dispozitat e ligjit material, ngase në rastin konkret janë plotësuar parakushtet e përcaktuara ligjore të përcaktuara me paragrafin 1 nën paragrafi 1.5 dhe 1.6 të nenit 60 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, pasi që sipas Aktgjykimit PKR.nr.102/22 të Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Krimeve të Rënda të datës 10.08.2022 ankuesi është shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale keqpërdorim i detyrës zyrtare apo autoritetit nga nenin 414 paragrafi 1 të KPRK-së të cilën e kishte kryer me dashje dhe se ankuesi e kishte pranuar fajësinë, ndërsa për kryerjen e veprës penale i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqindetëdhjetë) ditëve, dhe me pëlqimin e tij i shndërrohet në dënim me gjobë, sikurse konstatohet fakti se aktgjykimi i lartcekur e ka fituar formën e plotfuqishmërisë së tij me datë 05.09.2022.

Nga sa u tha si më lartë, bazuar në konstatimet e dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit të paraqitura në ankesën e parashtruar në Këshill, me datë 13.10.2022 janë të pabazuara ngase, në rastin konkret ankuesit i është përfunduar marrëdhënia e punës në shërbimin civil sipas fuqisë së ligjit i përcaktuar si në nenin 60 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *“Marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil përfundon për shkak të ligjit, kur: 1.5. dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje”* dhe se pretendimi i tij se shqiptimi i dënimit me burgim prej 180 ditësh i shndërruar në burgim me gjobë, sikurse edhe pretendimi ankimor se ankuesi paraprakisht pas pezullimit ishte kthyer në punë nga data 07.07.2022 sipas vendimit të datës 06.07.2022 të Kryetarit të Komunës së Gjilanit, nuk e shfajëson të njëjtin nga kryerja e veprës penale me dashje të përcaktuar si në konstatimin e dhënë nga Gjykata Themelore në Gjilan-Departamenti i Krimeve të Rënda përmes Aktgjykimit PKR.nr.102/22 të nxjerrë me datë 10.08.2022, ndërsa Kolegji i Këshillit thekson faktin se po ashtu Vendimi i datës 30.09.2022 i nxjerrë nga Menaxheri i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjilanit, është akt administrativ i ligjshëm në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative të përcaktuara si në nenin 47 dhe 48, sikurse pretendimet e palës ankuese nuk provohen me asnjë fakt apo provë materiale se akti i goditur me ankesë mund të jetë i paligjshëm në kuptim të nenit 52 i të njëjtit ligj, andaj mbi këtë bazë sikurse edhe mbi bazën e konstatimeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi, ankesa e ankuesit e datës 13.10.2022 refuzohet si e pa bazuar, ndërsa Vendimi me numër:016-115495 i Menaxherit të Njesisë së Burimeve Njerëzore me datë 30.09.2022 mbetet në fuqi sikurse është përcaktuar në dispozitivin e këtij vendimi.


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqësorës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nën 132 paragrafi 2 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËSYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.905/2022

Çlirim Zeka


Proçesmbajtës

Eshref SHABANI


Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit, Avokati
- Kryetarit të Komunës së Gjilanit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Gjilanit;
- Arkivit të KPMSHCK-së